



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 209/2010

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP), në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Ymer Hoxha dhe Muhamet Rexha, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Sladan Trajkovic në cilësinë e Anëtarit të Këshillit të Vendvotimit nga Parteshi, që ka të bëjë me parregullsitë gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me datë 23 Korrik 2010 mori këtë:

### V E N D I M

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

### A R S Y E T I M I

Z. Sladan Trajkovic në cilësinë e Anëtarit të Këshillit të Vendvotimit nga Parteshi, ka parashtruar ankesë më datë 18.07.2010, me të cilën pretendon se vëzhguesit e OJQ-së "Sveta Trojica", pavarësisht vërejtjes që iu është bërë, kanë vazhduar me regjistrimin e personave të cilët kanë ardhur për të votuar. Po ashtu sipas parashtruesit të ankesës ata kanë promovuar një subjekt politik.

### F A K T E T

Më 19 korrik 2010, KZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Z. Sladan Trajkovic në cilësinë e Anëtarit të Këshillit të Vendvotimit nga Parteshi, parashtruesi i ankesës pretendon se ka pasur parregullsi gjatë procesit të votimit, nga ana e vëzhguesve të OJQ-së "Sveta Trojica" nga Parteshi.

Parashtruesi i ankesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi si provë lidhur me parregullësitë gjatë procesit të votimit por ka përmendur vetëm Jedinstvena Srpska Lista "JSL" si dëshmitar.

### A N A L I Z Ë

Juridiksioni i KZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, neni 3.6, pika (b) dhe (c) parashohin si vijon:

*3.6 (b) Një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar*

*3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, ne rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit*

KZAP-i vlerëson se Ankesa është e parregullt për faktin se nuk përmban të gjitha elementet e detyrueshme të parashikuara në dispozitat e nenit 3.6 pika (b) dhe pika (c).

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

A nr. 209/2010 më datën 23 Korrik 2010

